



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
Dep.	2-D/DPK	Nr Prot.	01-3009/13
Dep.		Br Prot	
Nr. I faq		Prot No	
Broj stranica	02	Date	26-09-2013
Nr. pages		Datum	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.09.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2435/13 dhe 03-2436/13 për z. Fatmir Krasniqi – Anëtar në Kuvendin e Komunës së Dardanës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2435/13 dhe 03-2436/13, për Zyrtarin e Lartë z. Fatmir Krasniqi – Anëtar në Kuvendin e Komunës së Dardanës dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset “FUNGO” SH.P.K. dhe N.P.T. “Fungo F F”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Krasniqi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 21.08.2013) se ka filluar shqyrtimi i gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas kësaj, me datë 27.08.2013 zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë ku është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Krasniqi, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në bizneset private dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Ndërkohë, z. Krasniqi, ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës (DPKI 03-2862/13 dhe 03-2911/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga të qenurit person i autorizuar nga të dy bizneset e lartpërmendura, për të ushtruar funksionin e tij publik. Me këtë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

